



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr. 73 Prot

Tiranë, më 8.1. 2015

URDHËR

Nr. 7 datë 07.01. 2015

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “ PËR PROCEDURËN E KËRKIMIT,
PËRZGJEDHJES, PËRDORIMIT TË GJAKUT DHE KOMPONENTËVE TË TIJ NË
SPITALET E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 25 të Ligjit nr.9739, datë 21.05.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rekomandimeve të Komitetit Kombëtar të Gjakut,

URDHËROJ

1. Miratimin e rregullores “ Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë”.
2. Ngarkohen Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Bakat e gjakut në spitale, Drejtoritë e Spitaleve Universitare, Drejtoritë e Spitaleve Rajonale, Drejtoritë e Spitaleve në rrethe dhe spitalet jo publike, për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohen Drejtoria e Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Inspektorati Shëndetësor Shtetëror për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri.
4. Urdhri nr. 193 datë 12.05. 2008 Për miratimin e rregullores “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë ” shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ILIR BEQAJ

